

Hysen Doko¹

UDC: 316.346.32-053.6:37(496.5)
37:159.922.8(496.5)

ADOLESHENTËT DHE FAKTORËT E JASHTËM NDIKUES TEK TA

ТИНЕЈЏЕРИТЕ И НАДВОРЕШНИТЕ ВЛИЈАТЕЛНИ ФАКТОРИТЕ ВРЗ НИВ

ADOLESCENTS AND EXTERNAL FACTORS AFFECTING THEM

ABSTRACT

Adolescence is a stage of transition towards maturity. It is a transitional period of human physical and psychological development between childhood and adulthood, the purpose of which is to prepare for the responsibilities of adulthood. Adolescence occurs classically from the age of 12-14 to 20-22 years, but this is not definite, because for different people we have different ages of beginning and end of adolescence, depending on the development of the person, the environment where it grows, etc.

In cognitive terms, adolescence is characterized by the improvement of abstract thinking, knowledge and logical reasoning, we have a combination of abstract concepts with their concrete implementation or thinking about thinking. Also, in adolescence man already begins to take responsibility or gain confidence for decision-making, consultation about issues that can be considered serious and important.

Specifically in this paper we have presented some of the key factors that affect the education of adolescents. We then conducted a study of how these environments actually perform this function in the reality and daily life of adolescents in Albania. We hope that this article

¹ hysen.doko.hd@gmail.com, MSc. Candidate, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Master i Shkencave në Matematikë

will serve as a worthy reflection of the reality regarding the education of young people and be a good simulator of the consolidation of relations that these environments should create with tens.

Key words: ten, education, institutions, family, school, etc.

FAKTORËT E JASHTËM NDIKUES TEK ADOLESHENTËT

Faktorët e jashtëm ndikues tek adoleshentët janë të shumtë. Kjo varet nga rrethana të ndryshme si kultura, vendndodhja gjeografike, niveli i përgjithshëm arsimor, niveli kulturor etj. Në këtë punim do të paraqesim të grupuara tetë nga faktorët kryesorë ndikues tek adoleshentët, si tetë komponentët më të përgjithshëm dhe ekzistues pothuajse në çdo vend dhe çdo kulturë. Këto faktorë renditen si më poshtë:

- 1) Familja
- 2) Shkolla
- 3) Komuniteti i fshatit, lagjes, etj.
- 4) Media dhe rrjetet sociale
- 5) Shoqëria
- 6) Institucionet fetare
- 7) Shoqatat e ndryshme
- 8) Partitë dhe forumet politike

1. Familja

Familja përbën vatrën e parë dhe kryesore të edukimit të njeriut në çdo moshë, përfshirë këtu edhe adoleshencën. Prindërit duhet të jenë këshillëdhënës të mirë, sepse, familja është institucioni bazë ku realizohet formimi i adoleshentit. Ndikimi i familjes në formimin e personalitetit të individit nuk është i njëjtë në të gjitha moshat.

Ky ndikim veçanërisht është i theksuar në adoleshencë. Sidomos është tejet i lartë roli edukativ i nënës. Në familjet tona ende nëna është ajo që merr përsipër jo vetëm rritjen, por edhe edukimin e fëmijës, se kohën e lirë në familje adoleshentët e kalojnë kryesisht me nënën, por pa përjashtuar këtu dhe rolin e pazëvendësueshëm të babait.

Pra, familja vazhdon të luaj rolin primar në edukimin e adoleshentit, ajo formon jo vetëm përfytyrimet fillestare për të mirën dhe të keqen, për atë që lejohet e atë që nuk lejohet, por edhe bazat e edukimit moralo - social të adoleshentit.



Fig 1: Faktorët ndikues në edukimin e adoleshentit

2. Shkolla

Shkolla është institucioni më i rëndësishëm ndikues tek adoleshentët, sepse, adoleshenti atje kalon gjysmën e ditës dhe kryen shumicën e veprimtarive të tij ditore. Në shkollë ai përveç dijeve që fiton, fiton eksperiencë të mjaftueshme në lidhje me bashkëveprimin me të tjerët, me mjedisin e përbashkët, me më të mëdhenjtë, me më të dobët etj.

Një shkollë e cila e ka të balancuar fokusin mes dijeve shkencore dhe edukimit është një model i mirëfilltë edukimi, e cila tashmë ka marrë një rol shumë të rëndësishëm në komunitet dhe përbën faktorin kryesor implementues të këtij modeli në shoqëri.

3. Komuniteti i fshatit, lagjes etj.

Shpesh na duken të pandikueshëm ata të moshuarit dhe pensionistët që rrinë tek cepi i lagjes duke luajtur domino apo duke bërë muhabet, apo gjyshet duke pirë kafën me njëra tjetrën tek shtëpia e gjithsecilës me radhë çdo ditë. Për një moment të mendojmë sikur ata të bënin diçka që nuk përkon me etikën dhe moralin e përgjithshëm. A do i kuptonim vlerën atij mexhlisi dominoje apo muhabeti? Nga parimi “Të bardhës nuk i duket bardhësia vetëm se në prezencë të së zezës” kuptojmë që edhe komuniteti i lagjes, fshati apo zonës ku banojmë ka impaktin e vet tek të rinjtë. Veç kësaj dhe ambienti fizik, sa më tepër në përputhje me nevojat e komunitetit, të rinjve, apo sa më miqësor të jetë, ka një impakt

shumë pozitiv në mirëedukimin e të rinjve. Përmendim këtu rastin më të thjeshtë, nëse lagjia jonë ka kosha dhe kazane mbeturinash, kjo në vetvete përbën një komponent edukimi tek të rinjtë që edhe letra e ushqimit që kemi në dorë, edhe pse e vogël, e ka vendin e posaçëm tek kazani.

4. Media dhe rrjetet sociale

Me ecjen e shoqërisë njerëzore, edhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm tek krijimi i personalitetit të njeriut apo edukimit të tij ka ndryshuar.

Nëse bëjmë një qasje historike, para njëqind vjetësh ishte i paimagjinueshëm televizioni, telefoni, interneti apo kompjuteri. Por përsëri nga ana tjetër, nëse i qasemi kohës sonë, është e paimagjinueshme për të rinjtë e kohëve tona lojërat nëpër fusha me mjete rrethore, vizitat nëpër male, puna fizike vullnetare etj., sepse vetë dinamizmi i jetës dhe i zhvillimeve njerëzore ka bërë që këto të fundit të zëvendësohen dashur apo padashur me lojërat dhe shpenzimin e kohës në internet, telefon, duke parë televizor etj. Pyetja që lind natyrshëm është se çfarë impakti kanë këto në edukimin e të riut, specifikisht adoleshentit meqenëse fokusin kryesor të këtij punimi e kemi tek ta? Të flasësh për këtë temë së pari duhet të kesh disi informacion rreth politikave që edhe instancat shtetërore përdorin për të mbajtur nën kontroll mediat dhe rrjetet sociale në shërbim të një kauze kaq të lartë siç është edukimi. A kanë vendosur këto instanca ndonjë filtër rreth informacioneve dhe materialeve që shfaqen në këto rrjete? Dhe a ka shteti një formulë se si të filtrojë materialet që publikohen në këto media dhe rrjete sociale nga çdo përdorues, goftë ai person privat apo institucion?

Shteti turk për shembull ka bllokuar çdo lloj material pornografik dhe joetik të shfaqet në rrjetin e tij internet dhe në mediat e tij. Nuk mund të të dalin materiale pornografike në internet nëse lokacioni juaj është në Turqi edhe nëse ti vetë kërkon për të tilla, gjithashtu dimë që shumë shtete kanë të ndaluar përdorimin e Twitter apo rrjete dhe mënyra të tjera sociale të cilat bien ndesh me politikat edukuese dhe kulturore që ata kultivojnë dhe punojnë për t'i sintetizuar tek të rinjtë.

Pra themi që nëse mediat dhe rrjetet sociale shpërndajnë materiale të kontrolluara dhe të përshtatshme për çdo grupmoshë, dhe rasti më ideal edukuese, të rinjtë të cilët janë konsumatorët më të shumtë të këtyre mënyrave, minimumi atë material jo të përshtatshëm që do të shihnin do e shohin me natyrë edukuese dhe të përshtatshme për ta, dhe

gjithë sistemi i tyre do të marrë këtë rrjedhë përditshmërie, sepse vetë ambienti rrethues do të jetë i tillë, përmendim këtu përsëri shtetin turk për atmosferën që i krijon të rinjve me anë të mediave dhe rrjeteve sociale të kontrolluara, ambienteve fizike të përshtatshme nëpër lagje, parqe, biblioteka, fusha sportive, ambiente edukative etj.

5. Shoqëria

“Më thuaj me kë rri, të të them se kush je”; “Zgjidhe shokun më të mirë sesa veten”. Me këto citate popullore shohim qartë se nëse duam të dimë se kush jemi, le të shohim se me kë rrimë, nëse duam të zgjedhim shoqëri, le të jetë ajo më e mira e mundshme dhe nëse ka pasqyrë më të mirë për të parë veten, është pikërisht pasqyra e shoqërisë që të rrethon. Shoqëria, sidomos në moshën e adoleshencës është pothuajse më e shenjta për ta, ashtu siç dhe ata vetë shprehen se është si familja, pasi tek ajo gjejnë veten e tyre dhe janë më të lirshëm për të shprehur ato shprehitë moshore dhe detyrat zhvillimore. Një shoqëri e shëndoshë sjell individë të shëndoshë, dhe individë të shëndoshë përbëjnë një shoqëri të shëndoshë. Ky është një implikim logjik i dyanshëm i artë, tek i cili nëse i mëshohet edukimit qoftë edhe tek njëra anë, anën tjetër do e kemi të përgatitur vetvetiu. Shoqëria është ndër faktorët më të ngushtë ndikues tek adoleshentët pasi është periudha që për ta është e para në lista për nga ana e vëmendjes së kushtuar.

6. Institucionet fetare

Nevoja fetare është e pranishme në çdo kulturë në trajta të dukshme nga rite që kanë një vlerë shoqërore e munden të kenë një përmbajtje etike (udhëheqja e sjelljes së brendshme) dhe filozofike (dhënie përgjigjesh pyetjeve gjithësinorë). Themi bindshëm se qytetërime pa shtëpi, qytetërime pa sisteme fizike (lagje, qytet, qendra kulturore) janë gjetur, por qytetërime pa objekte kulti nuk janë gjetur dhe kurrsesi nuk mund të gjenden, edhe pse në mënyra dhe forma të ndryshme, këtu për shkak të kohës kur kanë jetuar dhe mënyrës se si i janë qasur Zotit.

Pra shohim qartë që nevoja për besim tek njeriu është i pashmangshëm, dhe logjikshëm dhe impakti që feja apo institucionet fetare lenë tek njeriu përsëri janë të pashmangshme. Ky impakt është pozitiv, dhe nëse realisht këto institucione zbatojnë atë që kanë në programet dhe urdhëresat e tyre hyjnore, do të kemi një shoqëri më të ndërgjegjshme, do të kemi një shoqëri më të kulturuar. Respekti ndaj personave zhduket në momentin kur këta persona nuk i kemi pranë. Natyrisht ne

nuk e nderojmë dhe respektojmë babanë i cili është në një qytet tjetër duke u ngritur në këmbë në dhomën e ndejës, sepse ai nuk është atje, kurse krejt e kundërta ndodh me respektin ndaj Zotit, i cili është në çdo sekondë pranë njeriut, duke shërbyer kështu si një rregullator i moralit të tij, ndërgjegjes së tij dhe kulturës së tij. Pra nxjerrim në përfundim se impakti që institucionet fetare lenë tek rinia, nëse realisht ata kanë kushtet për të frekuentuar të tilla përveç rasteve për zona apo fshatra që nuk kanë të tilla, është një impakt shumë pozitiv dhe që sipas mendimit tim duhet promovuar sepse atë që adoleshenti mëson në këto institucione nuk mundet kurrsesi ta mësojë as në shkollë, as në familje dhe askund tjetër.



Fig. 2: Ndikimi i institucioneve fetare në edukim

7. Shoqatat e ndryshme

Ndryshimet politike të viteve '90 bënë që edhe faktorët edukues apo ndërgjegjësues të njerëzve të ndryshojnë, duke shtuar elemente të reja apo duke rënë në hije elementet e asaj kohe. Një komponent ndikues që filloi të marrë jetë pas ndërrimit të sistemit është dhe ndikimi që shoqatat e ndryshme me karakter social, kulturor, fetar, artistik apo sensibilizues të kenë tek njerëzit, veçanërisht tek të rinjtë, ku në këto institucione ata përveç kohës së lirë që mund të kalojnë, të marrin dhe një paketë vlerash, virtytesh apo shprehish të cilat mund të kenë

karakter të ndryshëm, por roli final besoj se qëndron brenda së njëjtës kornizë. Në Shqipëri vlen të përmendim shumë shoqata bamirëse, kulturore, edukative, apo artistike të cilat luajnë një rol tepër të veçantë në edukimin e brezave të rinj, duke qenë faktor tepër kyç i jashtëm ndikues tek ta. Trekëndëshi “mësues - nxënës - prind” për edukimin e të riut, është e dukshme që nuk është i mjaftueshëm për të arritur edukimin e plotë me të gjitha cilësitë e larta njerëzore, dhe këtu një rol shumë të mire plotësues e marrin këto shoqata, bashkë me institucionet e kultit apo elementet e tjera të sipërpërmendura që janë ndikuese tek i riu apo e reja.

8. Partitë dhe forumet politike

Partitë dhe forumet politike luajnë një rol pothuajse jo të barabartë me kategoritë e tjera të përmendura më sipër në këtë punim, por megjithatë, përsëri roli i saj nuk është i papërfillshëm. Nëpërmjet programeve që këto parti apo forume kanë për të rinjtë, krijojnë një alternativë tjetër se si mund të kalohet koha e lirë, se si mund të ftohet për tek programi i tyre, se si pse jo mund të jesh një lider i ardhshëm etj. Edhe pse dihet që kulmin e aktivitetit këto forume e kanë në periudhat zgjedhore, përsëri mbetet të themi se zënë një vend të rëndësishëm në ndikimin që ato lenë tek të rinjtë, pasi për shumë të rinj modeli i prezantuar prej këtyre eventeve merret si kapital dhe promovohet përtej zyrave të partisë apo selisë së forumit.

Për të parë më nga afër ndikimin që këta faktorë kanë tek të rinjtë në Shqipëri, është zhvilluar një studim me adoleshentë të moshave 12 deri në 23 vjeç, ku pjesëmarrës kanë qenë 55 persona nga zona të ndryshme të Shqipërisë me shpërndarja rastësore dhe aspak të planifikuar. Është zhvilluar një pyetësor me rreth 20 pyetje të natyrave të ndryshme rreth faktorëve të jashtëm ndikues tek ta. Forma e intervistimit është bërë online me Google Form në linkun vijues ²:

² https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSegm-JZoicMar5XC514ddyE-1dwECGTSMmqYTVj3YJ4ag3jFg/viewform?usp=sf_link

9. Analizë e pyetësorit:




Fig. 3: Shpërndarja moshore

Në këtë pyetësor, nga 55 adoleshentë që morën pjesë, 43.6% e tyre ishin femra dhe 56.4% e tyre ishin mashkull, pra kemi pasur një shpërndarje gjinore pothuajse të barabartë, çka e bën të jetë më real si studim. Shpërndarja moshore e adoleshentëve varioonte nga 12 deri në 23 vjeç për të dy gjinitë, pra jemi brenda harkut moshor të adoleshencës.




Fig. 4: Arsimi i kryer ose në proces i të rinjve

Një tjetër pyetje e rëndësishme në hetimin e faktorëve ndikues dhe botëkuptimit të këtyre faktorëve është dhe shkollimi i të rinjve. Në lidhje me këtë pyetje, të rinjtë pohuan se 60% e tyre janë nga shkolla e mesme, 34.5% nga universiteti dhe 5.5% nga arsimi i detyruar 9 - vjeçar.




Fig. 5: Si e kalojnë kohën e lirë adoleshentët.

Për të studiuar ndikimin e faktorëve, pyetja e parë që do të bënim ishte se si adoleshentët e kalojnë kohën e lirë. Nga kjo pyetje vihet re se 42 nxënës kanë pohuar se më së tepërmi kohën e lirë e harxhojnë duke naviguar në internet dhe rrjete sociale, çka është e pritshme që ndikimi që ky komponentet të ketë tek të rinjtë të jetë më i madh. Ajo çka bie në sy në këtë grafik është fakti se asnjë nxënës nuk ka pohuar se nuk ka kohë të lirë, përkundrazi, të gjithë kanë kohë të lirë dhe menaxhimi i saj bëhet në mënyrat të cilat janë të cituara në grafikun e mësipërm. Me lojra në natyrë apo me veprimtari vullnetare kemi shumë pak nxënës të cilët angazhohen. Diçka tjetër që bie në sy është edhe fakti se 25 prej 55 nxënësve kanë pohuar se përdorin dhe leximin e librit si mënyrë për të menaxhuar kohën e lirë, çka është një element jo pak i rëndësishëm dhe shpresëdhënës.

Pyetja vijuese në pyetësor ka qene “A mendoni se kjo është mënyra e duhur për të kaluar kohën e lirë?”. Në këtë pyetje 63.6% e të rinjve mendojnë se kjo është mënyra e duhur për të kaluar kohën e lirë dhe vetëm 36.4% e të rinjve kanë pakënaqësi në lidhje me këtë mënyrë të të shpenzuarit të kohës së lirë.

Dhe më tej insiston pyetësori duke pyetur se nëse nuk mendoni se kjo është mënyra më e mirë për të kaluar kohën e lirë, çfarë sugjeroni ju, dhe në këtë pyetje të rinjtë shpreheshin se duhet të shtojnë aktivitetet fizike në natyrë, leximin e librit, aktivizimin rinor vullnetar, etj.

Në vijimësi të pyetësorit të rinjtë pyeten në lidhje me parqet rekreative dhe argëtuese në lagje. Kësaj pyetje 80% e nxënësve u janë përgjigjur Jo dhe vetëm 20% e tyre u janë përgjigjur Po.

Ata të cilët janë përgjigjur Jo, u është pyetur se si do të donin të kishin një ambient çlodhës në lagjen e tyre, dhe përgjigjja ishte se do të donin një park lojërash për fëmijët apo një ambient me gjelbërim ku të

rinjtë të kishin mundësi për të qëndruar dhe luajtur në mënyrë të shëndetshme, një bibliotekë apo një ambient sportiv.

Pyetja e radhës ishte në lidhje me organizimin në forume dhe organizime politike, ku 94.4% e të rinjve pohuan se nuk marrin pjesë në organizime të tilla, dhe vetëm 5.6% e të rinjve janë shprehur se marrin pjesë në organizime të tilla.




Fig. 6: A marrin pjesë në forume dhe organizata politike

Pyetja vijuese ka qenë në lidhje me përmbushjen e pritshmërive nga këto organizime, pra: “Nëse po, a jeni të kënaqur me ato çka ata përcjellin apo promovojnë dhe pse?”.

Në këtë pyetje të rinjtë janë përgjigjur se nuk janë të kënaqur sepse ata përdoren si mjet për të arritur objektivat e subjektit politik dhe për të masivizuar votimin e atij subjekti politik, dhe në qendër të agjendës së këtyre forumeve nuk është i riu, por vota. Diçka e tillë vihet re dukshëm dhe në aktualitetin ku jetojmë në Shqipëri, duke qenë në kohë zgjedhesh për Kuvendin e Shqipërisë.




Fig. 7: A frekuentoni institucione të kultit si xhami, kishë apo të tjera?

Studimi vazhdon duke pyetur nëse të rinjtë janë frekuentues të institucioneve fetare si xhami, kisha, teqe, etj. Dhe në këtë pyetje shohim se 60% e të rinjve janë frekuentues të këtyre institucioneve, çka është e pritshme se ky institucion ka ndikimin e saj në formimin dhe edukimin e adoleshentëve.

Pyetja e radhës ishte: “Çfarë mendimi keni për frekuentimin e të rinjve në këto institucione? A është apo jo pozitive për ta dhe pse?”. Në këtë pyetje përgjigjet ishin pozitive, pra mendonin se frekuentimi i këtyre institucioneve ka ndikim pozitiv tek të rinjtë sepse i mësojnë dhe edukojnë me ndërgjegje, me përgjegjshmëri dhe me një paketë vlerash të cilën nuk e merr në asnjë institucion tjetër. Vlen të përmendim disa prej këtyre përgjigjeve të cilat ishin: “Mendoj se është pozitive sepse i bën ata që të gjejnë veten e tyre.”, “Kjo është një gjë shumë pozitive pasi nëpërmjet fesë njeriu mëson se si të jetë i pastër në shpirt e zemër e në të gjitha drejtimit dhe e di se çfarë është e mirë dhe e keqe për të duke mos devijuar në rrugë të gabuara, siç janë droga alkooli duhani e shumë vese të tjera.

E ku ka më mirë që një person t'i praktikojë dhe ti marrë këto dije që në këtë moshë, moshë ku nis të kuptojë fillin e shumë gjërave.”

Një element tjetër i rëndësishëm që ndikon në formimin e të rinjve është edhe organizatat jofitimprurëse, të cilat e shtrijnë veprimtarinë e tyre në boshte të caktuara, si edukimi i të rinjve, formimi fetar, edukativ, etj., në varësi të llojit të OJF. Në lidhje me këtë pyetje, nga 55 nxënës të pyetur, 33 prej tyre pohuan se nuk marrin pjesë në forume dhe shoqata të tilla, kurse 22 prej tyre pohuan se marrin pjesë në këto forume. Ata të cilët kanë pohuar se marrin pjesë, kanë thënë se pjesëmarrja në këto forume ndikon në aspektin profesional, edukativ apo moral të të rinjve, dhe ky është një tregues shumë pozitiv në lidhje me impaktin që ato duhet të kenë në shoqëri.

Pyetja e radhës ishte: “Nëse shohim pak trendin e të rinjve sot, ata tentojnë të imitojnë apo ndjekin modele nga rrjetet sociale apo mediat, si këngëtarë, futbollistë, njerëz të famshëm etj. E parë nga këndvështrimi tuaj, a është pozitive dhe efektive marrja për model e shembujve të tillë? Argumentoni përgjigjen tuaj.”

Tek kjo pyetje përgjigjet ishin përgjithësisht negative, pasi të rinjtë nga tendenca për të imituar këta modele, të cilat në të shumtën e rasteve nuk janë shumë pozitive, po dalin nga natyrshmëria e tyre, duke imituar qorrazi dhe duke devijuar nga kultura, edukata dhe etika e tyre, pasi të shumtët personazhe që imitohen janë personazhe si këngëtarë,

futbollistë etj. Një ndër përgjigjet e nxënësve ishte: “Pjesërisht po dhe pjesërisht jo sepse jo të gjithë këto modele janë shembuj për tu mos u ndjekur pasi sot në media apo rrjete sociale ka plot personazhe që ja vlejné të merren si shembuj të mirë jo vetëm nga të rinjtë por e gjithë shoqëria, personazhe që promovojné edukim, dije, moral, pozitivitet etj.”

Pyetja e radhës ishte: “Në shkollë zhvillohen orë mësimi apo takime të posaçme në lidhje me marrjen e një roli pozitiv në shoqëri, rol ky i përfytyruar si i tillë nga vetë institucioni?”

Përgjigjet e nxënësve ishin negative, pra përgjithësisht nëpër shkolla nuk zhvillohen seanca apo takime të tilla, të cilat e orientojné të riun për tu faktorizuar në shoqëri.

Pyetja e fundit ishte: “Kur mendoni për të ardhmen, mendoni se ky brez që po rritet me një kulturë të mirë dhe të përshtatshme për vendin tonë apo të papërshtatshme dhe e thënë ndryshe jo shumë për tu marrë shembull?”

Nxënësit dhe tek kjo pyetje ishin pesimistë pasi mendojnë se të rinjtë po rriten me një kulturë jo shumë të përshtatshme dhe jo shumë të admirueshme.

10. Conclusions

From the questionnaire and the analysis of the influencing factors in adolescents, some conclusions are reached, which, summarized in points, are as follows:

1. The education of young people is influenced by important and inevitable factors such as: family, school, community, social networks, society, cult institutions, religious, political institutions, etc.

2. The impact that these factors have on young people is generally positive, but in certain situations, we may have negative influencing factors.

3. There is an urgent and unavoidable need for suitable facilities for young people, so that they can spend healthy time.

4. It is necessary to organize awareness-raising activities and topics by the school in order to educate young people to be a factor in society.

5. The models followed by young people are not very suitable to orient them and convey the true culture, adapting to the circumstances and traditions of our country.

6. Young people have lost self-esteem for themselves, thinking that they are not growing and being educated properly, as they are being influenced by unhealthy factors for their education.

RECENSENTË:

Dr. Asllan Vrapit³

MSc. Fatjon Kadillari⁴

11. Referenca:

1. Ceca, K. et al. (2011). *Kultura financiare në Shqipëri: rezultatet e vërtetimit për matjen e nivelit të njohurive financiare të popullatës*. Tiranë.

2. Grabova, P. (2013). *Ndikimi i kulturës dhe i emocioneve në sjelljen dhe vendimmarrjen financiare të individit*. Tiranë.

3. Nano, D. (2014). *Aftësia financiare e studentëve në Shqipëri*. Durrës.

4. Peng, T. C. M., Bartholomae, S., Fox, J. J., & Cravener, G. (2007). The impact of personal finance education delivered in high school and college courses. *Journal of Family and Economic Issues*, 28(2), 265–284. <https://doi.org/10.1007/s10834-007-9058-7>

5. Robb C. and Sharpe D. (2009). *Effect of personal financial knowledge on college students' credit card behavior*. *Journal* (25-43)

6. Dr. Aranti Gjipali, “Bazat psikologjike të edukimit”, cikël leksionesh.

7. Dr. Aranit Gjipali. “Bazat pedagogjike të edukimit”, cikël leksionesh.

8. Dr. Aranit Gjipali, “Bazat kulturore të edukimit”, cikël leksionesh.

³ Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit.

Email: asllan.vrapi@univlora.edu.al

⁴ Folës motivues, drejtor, Shoqata Ardhmeria, Dega Korçë

Email: fatjonkadillari@yahoo.com